



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DEVOLL  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Bilisht, më \_\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim Vendosje te kendit te lojrave per femije, Bilisht”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Lekundese per parqe lojrash 37535210-0; Stola 39113500-2**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,032,900 ( dy milion e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit e shtojces (Shtojca 9).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikate të vlefshme: ISO 9001: 2015 ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”.. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Kërkesa e cilësisë dhe standardeve është në përputhje me objektin e prokurimit dhe funksionin e mallrave të cilat do të përdoren nga femijet dhe autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të

jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatën e standarteve SH EN 1176-1: 2017+A1:2023 - ( Pajisje dhe sipërfaqe për sheshe lojrash kërkesa të përgjithshme të sigurisë dhe metodat e provës) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

SH EN 1176-1: 2017+A1:2023 është një standart që specifikon kërkesat e përgjithshme të sigurisë për pajisjet e kendit të lojrave për të gjithë femijet. Qllimi I këtij standarti është të sigurojë një nivel të duhur sigurie kur femijet luajnë në lodra, mbi ose rreth pajisjeve të kendit të lojrave. Ky standart është I zbatueshem për pajisjet e kendit të lojrave të destinuara për përdorim individual dhe kolektiv nga femijet. Ky standart specifikon kërkesat që do të mbrojnë femijet nga rreziqet e ndryshme gjatë përdorimit të tyre.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e lodrave pranë kendit të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor, instalimin konfigurimin e këtyre mallrave. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për një periudhë 1 vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë për garancinë e lodrave dhe se marrin përsipër të kryejnë zëvendësimin, riparimin e lodrave pa pagesë. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike për lodrat janë vendosur në përputhje me LPP-në dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në rastin konkret janë vendosur për të përshkruar teresinë e elementeve me të rëndësishme të lodrave të cilat garantojnë AK për cilësinë e tyre. **Specifikimet teknike janë vendosur duke pasur parasysh edhe faktin se këto janë lodra të cilat do të përdoren nga femijet për këto arsye qëllimi i AK ka qenë përcaktimi i tyre me qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e femijeve, për të marrë lodra me cilësi, jetegjatesi dhe sipas standarteve Europiane të sigurisë. Këto specifikime nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët operojnë këto fushe.**

## ‘SPECIFIKIMET TEKNIKE:

**1. LEKUNDESE TEKE DRURI ME 2 VENDE**

Strukture rezistente druri me dy ulëse me zinxhirë, projektuar për siguri maksimale dhe përdorim afatgjatë. 315x140x270 cm

Lekundsja te plotesoje standartet EN per sigurine dhe metodave te testimit per lekundjet.

**2. LEKUNDESE TEKE DRURI ME 2 VENDE**

Strukture rezistente druri me dy ulëse te varura ideale për të rritur kapacitetin e lojës njëkohësisht , projektuar për siguri maksimale dhe përdorim afatgjatë. 616x140x270 cm

Lekundsja te plotesoje standartet EN per sigurine dhe metodave te testimit per lekundjet.

**3. PESHORE E MADHE**

Lojë klasike balance prodhuar me barazpeshues statik meso dhe me doreza metalike dore e pershtatshme per grupmoshat 5+ vjec. 320x80 cm

**4. PESHORE E VOGEL**

Loje balance me permasa te reduktuara, e pershtatshme dhe e sigurt per femijet e vegjel te grupmoshes 2-5 vjec.240x45cm

**5. RRESHQITESE ME BAZAMENT**

Prodhuar dhe testuar ne kushte atmosferike me rezistence te larte ndaj rrezeve UV, dhe temperaturave te larta te rrezeve te dillit, e montuar mbi bazament te qendrueshem 315x65x170cm

Rreshqitesja te plotesoje standartet EN pwr sigurine dhe metodave te testimit per rreshqiteset.

**6. KULLA DRURI (4 COPE)**

Kompleks kryesor me 4 kulla druri te lidhura midis tyre, me cati dekorative, rethim mbrojtës dhe shkalle ngjitjeje.460x295x280cm

**7. STOLA ME DRU PA MBESHTETESE**

Stola urbane minimaliste me strukture metalike dhe derrasa druri te trajtuara per ambiente te jashtme. 150x48x45

**8. STOLA DRURI ME MBESHTETESE**

Stola klasike parku me mbeshtetese shpine, te projektuar per komoditet dhe qendrim ne natyre 155x52x78

**9. QENUSH ME SUSTE**

Loje lekundese teke me figure qenushi nga material Solid dhe suste profesionale celiku te trajtuar kunder thyerjes.97x35x75cm

**10. RROTULLUESE**

Karusel rrotullues metalik me dysheme druri/anti-rreshqitje dhe sistem kushinetash te mbrojtura per levizje te lemuar  $\Phi 150 \times 87$ cm

**11. Loje zbavitese me climbing**

Përmasat: afërsisht 1.50 m (gjatësi)  $\times$  1.20 m (gjerësi)  $\times$  1.50 m (lartësi).

Strukturë mbajtëse prej druri të trajtuar për përdorim në ambiente të jashtme.  
Rrjetë ngjitjeje prej litari polipropileni me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe kushteve atmosferike.

Lidhëse plastike ose metalike të sigurta dhe rezistente ndaj korrozionit.  
Të gjitha qoshet dhe sipërfaqet e drurit të lëmuara për sigurinë e fëmijëve.  
Instalim i fiksuar në tokë sipas standardeve të sigurisë për kënde lojërash.  
E përshtatshme për fëmijë të moshës 3–12 vjeç.  
Ngarkesa minimale e lejuar: 100 kg.  
Ngjyra dhe dizajni sipas modelit të miratuar nga autoriteti kontraktor.

## 12. PLLAKA GOME

Shtrese gome e përshtatshme për sigurinë e fëmijëve gjatë rënies në aktivitete fizike, rezistente ndaj konsumit dhe motit, të lejoje kullimin e ujit, 100% i riciklueshëm.

Dysheme fleksibël me granula gome, e prodhuar nga 100% granula gome SBR të ricikluara me madhësi 2–4 mm, e formuar nën temperaturë dhe presion të lartë për një periudhë të caktuar kohe.

Fortësia (Shore) e granulave dhe fibrave të gomës SBR duhet të jetë në intervalin 55–60.

Si lidhës për granulatat e gomës duhet të përdoret poliuretan njëkomponentësh, antikancerogjen, me vlerë rezistence  $5000 \pm 5\%$  MPa.

Pigmenti i bojës që përdoret për ngjyrosjen e granulave të gomës duhet të jetë pigment oksidi, i cili ndikohet shumë pak nga rrezet ultraviolett (UV).

Dendësia e materialit në gjendje përfundimtare duhet të jetë jo më pak se  $850 \text{ kg/m}^3$ .

Të gjitha materialet e përdorura në produkt do të jenë antikancerogjene.

Në pllakat e gomës do të përdoret pigment boje me bazë oksidi.

Përmbajtja e ngjitësit në produkt duhet të jetë të paktën 6%.

Përmasat e pllakave duhet të jenë  $40 \times 40 \times 2 \text{ cm}$ .

Nën pllaka do të ketë kanale kullimi uji me thellësi 5 mm.

Skajet e sipërme të pllakave do të kenë pjerrësi (chamfer)  $45^\circ$  dhe gjatësi 5 mm.

Pllakat do të prodhohen nga gomë me peshë jo më pak se  $16 \text{ kg/m}^2$ .

Pllakat e gomës do të prodhohen në ngjyrë jeshile.

Para ngjitjes në dysheme, sipërfaqja duhet të jetë e thatë dhe pa lagështi apo pluhur.

Në dysheme, materiali lidhës duhet të aplikohet si një shtresë e hollë me konsum  $1 \text{ kg/m}$ .

**13.** Të gjitha Lodrat duhet të përmbushin të gjitha standartet EN të përgjithshme të sigurisë.

Bashkengjitur do te gjeni skiakat per disa nga lodrat, zerat e tjere do te jene sipas specifikimeve teknike me lart.

**Njesia e Prokurimit:**